Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0871

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Sabit Makiqi., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME KËPUCË PËR POLICIN E KOSOVËS -Ritender" me numër të prokurimit 214-23-7137-1-1-1, me 01/02/2024, mori:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e bazuar ankesa e OE Sabit Makiqi B.I. me nr. 2023/871, e datës 06/11/2023, kurse vendimi i AK POLICIA E KOSOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME KËPUCË PËR POLICIN E KOSOVËS -Ritender" me numër të prokurimit 214-23-7137-1-1-1, ndërsa vendimi i AK mbetet në fuqi.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

POLICIA E KOSOVËS, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 20.07.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me këpucë për Policinë e Kosovës" me numër të prokurimit 214-23-7137-1-1-1. Ndërsa me datë 17.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim dhe vlera e parashikuar e kontratës1,240,860.00 €.

Me datë 23.10.2023, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të lartcekur të AK ndërsa me datë 26.10.2023 POLICIA E KOSOVËS refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik.

Me datën 06.11.2023 OSHP ka pranuar ankesën ngaOE Sabit Makiqi B.I, me numër të protokollit 871/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me këpucë për Policinë e Kosovës" me numër të prokurimit 23-7137-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE Sabit Makiqi B.I janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi Ankuesi pretendon se "*Si pike e pare e eliminimit sipas AK-së është se : OE ka sjelle Listën e kontratave ne oferte, e cila ne përmbajtje ka patur edhe artikuj tjerë përpos natyrës se njëjtë Apo te ngjashme. Me date 26.09.20231 kemi dërguar Letër Standarde ku I kemi kërkuar qe te na ofroj sqarime sipas kodit klasifikues. OE me date 02.10.2023 është përgjigjur Brenda afatit por nuk ka arritur te ofroj dëshmi te mjaftueshme. Vlera e cila ofrohet nga OE nuk e mbulon vlerën e kontratave nga Lista e Kontratave te ofruar ne ditën e ofertimit. Ne sqarimet e dhëna te datës 02.10.2023 OE deklaron një vlere te caktuar, e cila thotë nga shitjet privat por qe ne listën e kontratave te ditës se ofertimit nuk gjenden dhe nuk mund te pranohen sepse do te konsiderohej ndryshim material, dhe se nga ato shitje nuk ka referenca por vetem gjendjen e bankes e ciia nuk ka qene kriter ne DT dhe Njoftim per kontrate Andaj nuk e ploteson kriterin.; sqarojmë se, nuk qëndrojnë këto konstatime pasi ne Dosje te tenderit janë kërkuar referenca te ngjashme : Kërkesa 5 : Operatori ekonomik për Pjesën 1 duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere minimum 1,500,000.00€. kompanija jone ka ofruar listën e kontrates dhe referencat me furnizime qe kane te bëjnë me uniforma qe eshte furnizim i ngjashëm qe ne kuadër te kësaj qdo autoritet qe i shpalle furnizime me uniforma (uniforma ka kuptim komplet pra veshmbathja) te cilat ne kuadër te saj hynë edhe këpucët çizmet helmëtat dhe dorezat janë furnizime te ngjashëm. Ne listën e referencave ne ju kemi dëshmuar se kemi furnizime te ngjashëm 3,516,702.80€ ku qdo tender qe eshte shpallur nga AK te Kosovës këpucët janë shpallur me uniforma dhe ne i kemi te gjitha furnizime te ngjashëm siqe ka qene kërkesa e dosjes se tenderit mbi 3,516,702.80 , pra te gjitha tenderët janë me uniforma dhe Uniforme kuptohet prej kokës deri te këpuca quhet uniforme –veshmbathje. Shiko listën e referencave.*

Gjithashtu ne ju kemi dëshmuar ne sqarimin e datës 28.09.2023 se 717.162.00 euro kemi furnizime te njëjta me këpucë me Autoritet Kontraktuese ne te gjitha Autoritet Kontraktuese te Kosovës ndërsa 1,200.000.00 € me kompanitë private te gjitha këto ju dëshmojnë me fletëpagesa si dëshmi dhe AK-se te Policisë se Kosovës ja kemi dëshmuar me qarkullim bankar. AK e Policisë se Kosovës duhet ti beje vlerësimin e referencave ne baze te nenit 59 te LPP-se dhe ne baze te nenit 69 pasi ne dosjen e tenderit është kërkuar referenca te ngjashëm ne dosjen e tenderit dhe kemi dorëzuar referencat e ngjashëm. Sa per informimin e komisionit te vlerësimit ne kemi 10 dyqane ne gjithë Kosovën me furnizim me këpucë këtë e dine shume mire AK i Policisë se Kosovës por kjo është duke u bere e qëllimshme, mundeni me ardh mi i vizituar te gjitha dyqanet tona me këpucë.

AK-ja refuzimin qe na ka dërguar është po i njëjti arsyetim qe na është dërguar për eliminim dhe nuk kane mundur te demantojnë pretendimin tone qe kemi thane se është kërkuar e ngjashëm referencat dhe ne ju kemi ofruar referenca te ngjashme është veshmbathja dhe ne ju kemi ofruar referenca te mjaftueshëm për veshmbathje. 3,516,702.80 euro kontrata te nënshkruara Faqe 8 nga 15 Pra me këtë AK-ja e Policisë se Kosovës dëshmon se edhe ne këtë tender si ne tenderët paraprake qe nga viti 2016 nuk jemi te mirëpritur nga këta njerëz dhe qe nga viti 2016 nuk kemi marr asnjë kontratë për këpuca".

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se*"pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Është kërkuar qe pjesa e perparme e sholles te jete 1.2 -1.5 cm, OE e ka sjelle 1cm pjesen e perparme te shollës nuk qëndron konstatimi i AK-se, i komisionit te vlerësimit pasi pasi ne prezencë te punëtores se prokurimit znj. Vatovci z . prokurimit e kemi mat pjesën përparme te shollës qe sipas matjes qe e beme del 1.2 cm qe dmth përputhet me matjet tona me matjet qe janë ne atest te laboratorit 1,2cm qe ne baze te këtyre matjeve qe ne i kemi bere dhe qe po ju dëshmojmë me foto mundem me konstatuar se kompania jone "Sabit Makiqi B.I. A&V Collection NP" i përmbushim specifikimin teknik te dosjes se tenderit. Shikoni foton: Gjithashtu ne ju kemi drejtuar edhe prodhuesit me këtë arsyen e eliminimit dhe prodhuesi na ka dërguar matjet profesionale me NONJUS . Shiko foton Faqe 9 nga 15 Kompania jone kërkon nga eksperti i OSHP-se edhe Bord i OSHP-se si qe shihet këpuca jone i plotëson specifikat duke u bazuar te gjoni këpucës është 1,3 cm dhe matjes behet me NONJUS e jo me metër si qe ka mat komisioni i vlerësimit, atëherë kërkojmë nga eksperti edhe panelit qe ti dërgojnë për matje ne ndonjë Institut Shtetëror te licencuar te matjeve e jo te na eliminojnë ata qe s'kane lidhje me këpuce se një eliminim i tille për kompaninë prodhuese është ofendim. Gjithashtu ne mundem me konstatuar se komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit me arsyetime te tilla te pa baza dhe ne kundërshtim te plote me ligjin e prokurimit dhe ne kundërshtim me matjet e laboratorit po mundohen me na eliminuar qëllimisht nga konkurrenca dhe qëllimisht me na dëmtuar kompaninë tone për me i realizuar qëllimet e tyre me kompanitë e veta. AK-ja - Gjithashtu edhe ne këtë pretendim nuk kane qene real ne refuzimin e kërkesës për rishqyrtim pasi si qe e shini ju si ekspert vërehet qarte se sholla është 1.2-1.5 por kjo është bere qëllimisht nga AK-ja."*

Pretendimi i tretë (III): Ankuesi pretendon se *" pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Gjatësia e lidhëseve te këpucëve duhet te jete 80 deri ne 100 cm, OE e ka sjelle 78cm Andaj OE konsiderohet I papërgjegjshëm nuk qëndron konstatimi i AK-se, i komisionit te vlerësimit pasi ne prezencë te punëtores se prokurimit znj. Vatovci z . prokurimit e kemi mat gjatësinë e Faqe 10 nga 15 lidhëses është sipas specifikimeve te dosjes se tenderit 80, cm shikoni foton e bashkangjitur këtë dëshmon edhe atesti i laboratorit me numër Nr. 107NA/31.08.2023 r. Shikoni foton qe e kemi matur ne prezence te OE. Ne baze te këtyre konstatimeve ne si kompani mundem me konkluduar se komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit ka vepruar kundërshtim me laboratorin së pari por janë edhe kundërshtinë me nenin 28 te LPP_se pasi janë te përcaktuar standardet qyshe kërkohen ne nenin 28 te LPP_se standardet evropiane ose standardet e mallrave qe i kane kërkuar ne dosjen e tenderit dhe prodhuesi i ka bere lidhëset sipas standardeve qe janë kërkuar qe ne si kompani e kemi plotësuar gjatësinë e lidhëses. Pretendimet tona për OE te rekomanduar për kontrate. Ak-ja edhe për kundër fakteve te lëshuar nga laboratori (atesti qe ka qene i bashkangjitur me oferte) qe ne ju kemi ofruar ne kërkesës për rishqyrtim AK-ja prap se prap ka mbet pranë arsyeve te eliminimit pa kurrfarë arsyetim për gjetësin e tojës qe është bere ne laborator. Kërkojmë nga OSHP-ja qe te dërgojnë çfarëdo laboratori te bëjnë matjen ose te pyetni laboratorin".*

Pretendimi I katërt (IV)*: Ankuesi Pretendon se "Ne fletushkën e OE Solid shpk qe është i rekomanduar për kontratë ne fletushkën qe e kemi gjetur ne mostrën e këpucës nuk përputhet me specifikacion teknik te kërkuar ne dosjen e tenderit qe ne baze te Faqe 11 nga 15 kësaj komisioni i vlerësimit shihet se ka qene subjektiv ne vlerësim te ofertave . Kompania jone mundet me konkluduar se OE i rekomanduar për kontratë mostrën qe ka dorëzuar ka ra kundërshtim me veten dhe me specifikimin teknik te dosjes se tenderit pasi shkruar ne fletushke te mirëmbajtjes dhe mostrën këpucës qe ka dorëzuar shkruan standardi EN 347 qe nuk ka standard standard EN 347 por ne dosjen e tenderit është kërkuar standardi 20347 pra me ne një fjalë është kundërshtim me veten dhe kundërshtim me specifikat teknike Shiko dosjen e tenderit : 1. Standardi EN ISO 20347 duhet te dëshmohet me flete inspektim apo raport testues Shiko standardin te maja e kimikut ne foton e fletushkës e kompanisë Solid Shpk.".*

Pretendimi I pestë (V)*: Ankuesi Pretendon se "*Gjate qasjeve ne ofertat te OE Solid shpk lidhësja e këpucës qe e kemi matur ne prezence te znj. Satovci është e gjate 101 cm , ndërsa kompaninë tone Sabit Makiqi B.I A&V Collection na eliminoj padrejtësisht duke na diskriminuar haptazi dhe ne kundërshtim me LPP-ne pasi shihet se ne kemi lidhësen 80 cm sipas specifikave te dosjes se tenderit ndërsa OE i rekomanduar e ka 101 cm kundërshtim me specifikat teknike dhe nuk e eliminoj".

Pretendimi I gjashtë (IV)*: Ankuesi Pretendon se: "Gjithashtu ne dyshojmë se nuk ka as ateste te lidhëse te dorëzuar qe është kërkuar ne dosjen e tenderi pasi neve nuk na kane jep qasje mi shikuar atestet qe është kundërshtim me nenin 10 te LPP_se pasi atestet nuk munden te konsiderohen sekret afarist se është specifikim teknik qe i bije se nuk është sipas nenit 11 qe thotë vetëm dokumentet qe kane te bëjnë me neni 68 dhe 69 munden te konsiderohen sekret afarist. Për këtë kërkojmë nga komisioni i vlerësimit apo eksperti qe do ta shqyrtoj lenden ti*

shikon atestet për lidhësve, sepse ka qen kriter qe te ketë atest për lidhe kundër ujit! dhe ky Laborator ne faqen zyrtare No. LT004 te laboratorit nuk e ka ketë standard te akredituar. Faqe 13 nga 15 Bazuar ne kërkesën e specifikimit teknik per këpuca rezistues ndaj ujit, Laboratori ne fjale nuk ka akreditim per testimet si ne vijim; Rezistent ndaj ujit , as standardit EN ISO 20347 Ku munde te shihni ne faqen zyrtare Lobratorit LT-004 Ku vetë ky laborator shumë qart i ka dokumentuar qe Atestet te cilat i kryen për Lëkur dhe për Këpucë prej numrit rendor numër 56 deri ne faqen 92 as kund nuk shifet qe ky lebrator nuk është i akredituar për këto standarde. Standardet kundër ujit dhe per standardin EN ISO 20347 nuk është i akredituar MAK –KONTROLL. Si qe jen kërkua ne specifikimin e DT i secili ka qene kriter kryesor: Këpucë me lidhëse model Derby me nivel te ulët, me sistem ajrosje dhe rezistues ndaj ujit mbështjelle me shtrese TPU - PUR (Thermoplastic Polyurethane) ose ekuivalent antistatike , ngjyra e zezë. ·· Gjatësia e lidhësve te këpucëve duhet te jete 80 deri ne 100 cm dhe te jene rezistuese ndaj ujit, Kërkojmë nga komisioni i rivlerësimit apo eksperti shqyrtues te shikoj a i ka te dorëzuar atestet për këpuca, lidhësja si qe ka qene kërkesa e dosjes se tenderit, te shikoj a është i akredituar laboratori i atesteve, sipas standardeve a e ka certifikatën e akreditimit laboratori pasi ne mendoj se i ka manipuluar atestet dhe te vërtetohen atestet pasi kemi dyshime se janë marr atestet ne Maqedoninë e veriut dhe ky laboratorë nuk standardit te akreditur rezistenca ndaj ujit dhe nuk Këpucët duhet te sigurojnë mbrojtje sipas standardit EN ISO 20347 akredituar, dëshmi certifikatën e Laboratorit No. LT-004. Shikoni certifikatën e akreditimit te Laboratorit: MAKKONTROL dëshmi faqja 56- deri 92 për Lëkur dhe këpuce".

***Pretendimi I shtatë (VII)**: Ankuesi Pretendon se "Siç po shihet me larte AK e ka rekomanduar kundërligjshëm këtë aktivitet te prokurimit pasi qe neve i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT pra kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm dhe me Çmimin më te ulët. Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues Faqe 14 nga 15 do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Si dhe ne piken 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. AK nuk i ka vlerësuar ne mënyrë te barabarte te gjithë OE-te te cilët kane aplikuar ne këtë aktivitet te prokurimit. AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, ku neve kemi ofertuar me ofertuar me Tender të përgjegjshëm dhe me Çmimin më te ulët. Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe me Çmimin më te ulët. Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi dhe ti respektoj kërkesat e veta qe vet i ka vendosur ne NJK dhe DT lidhur ne këtë aktivitet te prokurimit dhe te nxjerr:".*

***Pretendimi I tetë (VIII)**: Ankuesi Pretendon se "Kompania jone mendon se është shkelur neni 11 i LPP_se pasi nuk na është dhënë qasjen e plote siqe kërkohet me këtë nen te ligjit te Prokurimit dhe kërkoj te merren masa ndaj personave qe nuk na është dhëne qasja pasi kjo lejohet me ligj dhe duhet te na jepet verzioni i pastër i aktivitetit te prokurimit pra te gjitha dokumentet qe lejohen me LPP_se. Pasi vetëm dokumentet qe kane te bëjnë me nenin 68 dhe 69 munden te konsiderohen si sekret afarist por jo Lista e referencave, certifikatat dhe atestet nuk hyn ne nenin 69 pasi janë certifikata dhe konsiderohen me neni 66 te LPP_se."*

***Pretendimi I nentë (VIII)**: Ankuesi Pretendon se "Kërkojmë nga komisioni i rivlerësimit te e shikoj ofertën e Solidit shpk se a i ka plotësuar kriteret e dosjes se tenderit pasi nuk na është jep qasje krejt ofertën: 1. Referencat nuk e dimë a i ka plotësuar qe është kërkuar ne tri vitet e fundit prej 1.000.000.00€ 2. Certifikatat ISO 9001:2015 dhe EN ISO 14001:2015 valide a janë Faqe 15 nga 15 3. Certifikatën e Laboratorit EN ISO 20347 Ak-ja ne pretendimet tona qe i kemi pasur për OE te rekomanduar Solid shpk nuk është përgjigjur fare kjo vërehet qarte se kane pasur interesa personale me kompaninë e rekomanduar edhe pse ka pasur shume pretendime."*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "Sabit Makiqi" B.I konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin ,6, 7, 10, 11, 59, 60 dhe 69 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 871/23, ndërsa me datë 21/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0871 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK POLICIA E KOSOVËS, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues duke theksuar "

Autorit kontraktues PK nuk pajtohet me mendim e eksperti shqyrtues 2023/871, pasi qe nuk kane trajtuar materilalin sipas LPP-se dhe Rregullores 01/2022. AK kundërshton fuqishme ekspertizën , eksperti ne ekspertizën e tij ka gjen i një anshëm dhe jo profesional mbi te cilën OE ankues është eliminuar.

Asnjë nga sqarimet e ekspertit teknik nuk qëndrojnë pasi qe nuk ka vlerësuar sipas kërkesës se AK sipas njoftim për kontrate dhe FDT-se. OE ankues është i pa përgjegjshme pasi qe nuk i ka plotësuar kërkesat ne DT dhe ne njoftimin për kontrate.

Te lista e kontratave OE ankues nuk ka kontrata te realizuara sipas kërkesës ne DT dhe ne njoftimin për kontrate pasi qe referencat e ofruara nuk i plotësojnë vlerën e kërkuar. Ne kontratat e realizuara nga OE ankues janë kontrata qe kane te bëjnë me furnizim me uniforma zjarrduruese (duke përfshirë xhaketa, pantollona, nenkapela, doreza si dhe çizme) e jo me këpuce pasi qe vete kodi i Fjalorit te Prokurimit Publikim është 19300000-9 qe ka te beje me këpuce –Lëkurë, produkte lëkure dhe këpucë ku si te ngjashme hynë çizmet dhe produkte tjera qe kanë te bëjnë me lëkurë. Uniforma nuk mund te jete e ngjashme ashtu siç pretendon eksperti ne ekspertizën e tij.

Kodi i fjalorit te prokurimit me te cilët vërtetohet se uniforma nuk mund te jete e ngjashme për kontrata qe ka OE ankues me Agjencia e menaxhimit Emergjent pasi qe këto kontrata kanë fjalorin e prokurimit 18115100-9 uniforma zjarrfikësve. Arsyet e eliminimit te OE ankues e gjeni si me poshte.

Sabit Makiqi B.I., 9/A, MULLA IDRIZ GJILANI, -, PRISHTINË, Kosovë Pjesa 1

OE k deshtuar ne: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kerkesa 5 : Operatori ekonomik për Pjesën 1 duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere minimum 1,500,000.00€.

Deshmi 5: Operatori Ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të projektit, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuar me referenca ose fletë pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse publike ose private.

Vërejtje; Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve, kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë.

OE ka sjelle Listën e kontratave ne oferte, e cila ne përmbajtje ka patur edhe artikuj tjerë përpos natyrës se njëjte Apo te ngjashme.

Me date 26.09.2023 I kemi dërguar Letër Standarde ku I kemi kërkuar qe te na ofroj sqarime sipas kodit klasifikues. OE me date 02.10.2023 është përgjigjur Brenda afatit por nuk ka arritur te ofroj dëshmi te mjaftueshme. Vlera e cila ofrohet nga OE nuk e mbulon vlerën e kontratave nga Lista e Kontratave te ofruar ne ditën e ofertimit. Ne sqarimet e dhëna te datës 02.10.2023 OE deklaron nje vlere te caktuar, e cila thote nga shitjet privat por qe ne listën e kontratave te ditës se ofertimit nuk gjenden dhe nuk mund te pranohen sepse do te konsiderohej ndryshim material, dhe se nga ato shitje nuk ka referenca por vetëm gjendjen e bankës e cila nuk ka qene kriter ne DT dhe Njoftim për kontrate Andaj nuk e plotëson kriterin.

OE gjithashtu ka dështuar tek Aneksi 1 Specifikacionet Teknike

Është kërkuar qe pjesa e përparme e shollës te jete 1.2 -1.5 cm, OE e ka sjelle 1cm pjesën e përparme te shollës

Gjatësia e lidhëseve të këpucëve duhet te jete 80 deri ne 100 cm, OE e ka sjelle 78cm

Andaj OE konsiderohet I papërgjegjshëm

Te gjitha këto kundërshtim do ti paraqesim, edhe me a-mail te OSHP si dhe ne seancën përfundimtare te cilën kërkojmë te mbahet dhe ti paraqesim te gjitha faktet, ti pasqyrojmë te gjitha këto me dokumente qe OE ankues ka ofruar bashke me ofertën financiare.".

Ndërsa OE Sabit Makiqi, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Sabit Makiqi eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0871 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i bazuar pasi që: "*Pretendimi i parë ankimorë ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka arritur të përmbush vlerën e kërkuar prej 1.500.000€ kontrata të natyrës së ngjashme pasi sipas AK-së në letër standarde për eliminim : "OE ka sjelle Listen e kontratave ne oferte, e cila ne permbajtje ka patur edhe artikuj tjere perpos natyres se njejte Apo te ngjashme." OE ankues pretendon se plotëson dhe tejkalon kërkesat dosjes së tenderit. Sqarojmë se kërkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë si në vijim: "Kerkesa 5 : Operatori ekonomik për Pjesën 1 duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere minimum 1,500,000.00€.". Pas analizimit të ofertës së OE ankues, kemi gjetur se i njëjti nga lista e kontratave që ka ofruar ku ka renditur 9 kontrata, vetëm me 3 kontrata nga kjo listë e plotëson dhe tejkalon kërkesën e dosjes për kontrata të natyrës së ngjashme . Për këto kontrata OE ka ofruar referencat pozitive nga autoriteti përkatës. Provë : referenca me vlerë 657.289.80€ për "Furnizim me Uniforma të Punës dhe Këpucë për Zjarrfikës nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent. Provë : referenca me vlerë 1,134.364.00 euro për "Furnizim me Uniforma dhe Helmeta Mbrojtëse për Zjarrfikës. Pjesa (Llot) 1 Furnizim me Uniforma mbrojtëse nga zjarri (Xhaketa zjarrduruese, Pntollonat zjarrdurues ,Çizmet zjarrdurues ,Nënkapela zjarrduruesese, Dorëzat zjarrduruese), nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent. Provë: referenca 1.181.480 për "Furnizim me uniforma sportive per nevoja te FSK-se e ndare ne dy pjes – Lot 2''Furnizim me atlete sportive për nevojat e FSK[1]së'' nga MINISTRIA E MBROJTJES. Mendimi ekspertit është se vetëm me këto tri kontrata plotësohet dhe tejkalohet kërkesa e AK-së. Arsyetimi i AK-së se "OE ka sjelle Listen e kontratave ne oferte, e cila ne permbajtje ka patur edheartikuj tjere perpos natyres se njejte Apo te ngjashme" nuk është na pajtim me kushtet e tenderit, pasi në dosje të tenderit është këkruar "kontrata të natyrës se njëjte OSE TE NGJASHME". Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se eliminimi i AK-së në këtë pikë është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.".*

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar pasi që "*Pretendimi tjetër ankimorë ka të bëjë me arsyen e eliminimit , ku sipas AK-së OE ankuers "OE gjithashtu ka deshtuar tek Aneksi 1 Speciflkacionet Teknike është kërkuar qe pjesa e përparme e shollës te jete 1.2 -1.5 cm, OE e ka sjelle 1cm pjesen e perparme te sholles Gjatesia e lidheseve te kepuceve duhet te jete 80 deri ne 100 cm, OE e ka sjelle 78cm Andaj OE konsiderohet I papërgjegjshëm." Fillimisht duhet të cekim se nuk jemi të njoftuar se kush nga AK dhe në çfarë mënyrë apo në çfarë laboratori i kanë bërë matjet. OE ankues pretendon se kjo është kosntatim i gabuar i AK-së dhe ka ofruar dëshmi nga prodhuesi si duhet bërë matja, ku sipas matjeve të prodhuesit trashësia është në pajtim me kërkesat e dosjes. Përveç kësaj, OE ankues në ofertë ka prezantuar edhe raportin e testimit nga laboratori ku shihet se trashësia është brenda parametrave të lejuar 1.2-1.5cm. Provë : Raporti i testimit nr.107NA/31.08.203 Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.".*

Pretendimi i tretë (III) ankimor është i bazuar pasi që *"pretendimi tjetër ankimorë ka të bëjë me arsyen e eliminimit , ku sipas AK-së OE ankues OE gjithashtu ka dështuar tek Aneksi 1 Specifikacionet Teknike është kërkuar qe pjesa e përparme e shollës te jete 1.2 -1.5 cm, OE e ka sjelle 1cm pjesën e përparme te shollës Gjatësia e lidhëseve te këpucëve duhet te jete 80 deri ne 100 cm, OE e ka sjelle 78cm Andaj OE konsiderohet I papërgjegjshëm." Fillimisht duhet të cekim se nuk jemi të njoftuar se kush nga AK dhe në qfarë mënyrë apo në qfar laboratori i kanë bërë matjet. OE ankues pretendon se kjo është konstatim i gabuar i AK-së dhe ka ofruar dëshmi nga qasja/matja e mostrave, Përves kësaj, OE ankues në ofertë ka prezantuar edhe raportin e*

testimit nga laboratori ku shihet se trashësia është brenda parametrave të lejuar 80-100cm. Provë : Raporti i testimit nr.107NA/31.08.203 Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.".

Pretendimi i katërt (IV) ankimor është i bazuar pasi që *"Pretendimi tjetër është se OE i rekomanduar ka ofruar një "fletushkë" në të cilën shënon standardi EN 347. OE ankues pretendon se ky standard nuk është ajo çka është kërkuar , që është kërkuar realisht EN ISO 20347. Po ashtu sipas OE kjo nuk plotëson kërkesën e dosjes për "raport të testimit". Me qenë se OE ankues nuk i është lejuar qasja në këto dokumente, ne kemi analizuar ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi gjetur se për këtë kërkesë OE i rekomanmduar ka prezantuar jë raport testimit , mirëpo vlerësojmë se ky raport nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e AK-së. Fillimisht theksojmë se në këtë raport askund nuk shënon se është bërë testimi i këpucëve. Pastaj nuk përmban asnjë standard/testim sipas EN ISO 20347 apo metodave tjera te testimit që përdoren për plotësimin e kërkesave që dalin nga ky standard, siç janë komforditeti, qëndrueshmëria, rezistenca ndaj rrëshqitjes etj. Nga analizimi mëtutjeshëm duket se ky testim është bërë për lëkurë dhe jo për këpucë, ndërsa kërkesa dosjes ka qenë që "produkti i ofruar është në përputhje me standardin EN ISO 20347. Në rastin konkret produkti i cili ofrohet/prokurohet është këpuca si tërësi e jo lëkura. Kjo definohet edhe përmes dosjes së tenderit në specifika teknike ku decidivisht thuhet : "Këpucët duhet të sigurojnë mbrojtje sipas standardit EN ISO 20347 (pajisje mbrojtëse personale)" Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar dhe se OE nuk ka arritur të dëshmojë se produkti i ofruar është në përputhje me standardin EN ISO 20347.*

Pretendimi i pestë (V) ankimor është i bazuar pasi që "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar se produkti ofruar është në pajtim me kërkesën e dosjes për lidhëse rezistente ndaj ujit. Prapë duhet të cekim se raporti testimit të OE të rekomanduar , nuk përmban as këtë të dhënë/testim, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.".*

Pretendimi i gjashtë (VI) ankimor është i bazuar pasi që "*OE ankues në mungesë të qasjes në dokumente të OE, pretendon se OE i rekomanduar sigurisht nuk Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Sabit Makiqi B.I.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME KËPUCË PËR POLICIN E KOSOVËS -Ritender" me numër të prokurimit: "214-23-7137-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS plotëson kërkesat për referenca në tri vitet e shkuara dhe po ashtu ngritë dyshime rreth ISO standardeve të OE. Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar kemi gjetur se i njëjti i plotëson këto kërkesa. Ndoshta vlen të ceket njëra nga ISO certifikatat është vazhduar një ditë para afatit për ofertim, dhe me atë numër të certifikatës nuk kemi mundur ta vërtetojmë certifikatën në faqe të lëshuesit/certifikuesit, megjithatë nga të dhënat në certifikatë duket të jetë valide".*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave,

konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME KËPUCË PËR POLICIN E KOSOVËS - Ritender" me numër të prokurimit: "214-23-7137-1-1-1. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndaj OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të ultë.

Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tyre janë të pranueshme në mënyrë të pjesërishme nga ana e këtij paneli, për faktin se në këto raporte është konsideruar se në shumë pika nuk përmbajnë argumente, të gjetura dhe fakte të mjaftueshme, andaj është arritur deri tek vendim-marrja përfundimtare që të mbetet në fuqi vendimi i AK, andaj PSH do ta elaboroj vetëm pikat ankimore të cilat nuk kanë gjetur mbështetje të plotë për dallim nga raporti i ekspertizës:

Ankuesi ka atakuararsyen e eliminimit të tij/saj, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka arritur të përmbush vlerën e kërkuar prej 1.500.000€ kontrata të natyrës së ngjashme pasi sipas AK-së në letër standarde për eliminim : "OE ka sjelle Listen e kontratave ne oferte, e cila ne permbajtje ka patur edhe artikuj tjere perpos natyres se njejte apo te ngjashme. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues ka deklaruar se Ankuesi ka ofruar dëshmi dhe refrenca të cilat e përmbushin vlerën e kërkuar nga AK, por nuk ofron asnjë faktë apo argument se në çfarë mënyre i klasifikon si të ngjajshme. Andaj, Paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si të pabazuar, duke ju përmbajtur Opinionit të KRPP Nr. 11 të publikuar më datë 09.06.2023, se KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dhe në këtë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik, atëherë AK në mendimin ndaj raportit të ekspertizës ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit sepse pikë orientimi i klasifikimit të këtyre kontratave ka qenë FPP.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me arsyen e eliminimit të Ankuesit, ku sipas AK-së OE ankuers "OE gjithashtu ka deshtuar tek Aneksi 1 Speciflkacionet Teknike është kërkuar qe pjesa e përparme e shollës te jete 1.2 -1.5 cm, OE e ka sjelle 1cm pjesen e perparme te sholles Gjatesia e lidheseve te kepuceve duhet te jete 80 deri ne 100 cm, OE e ka sjelle 78cm Andaj OE konsiderohet I papërgjegjshëm. Ekspertit deklaron se sipas matjeve të prodhuesit trashësia është në pajtim me kërkesat e dosjes. Përveç kësaj, OE ankues në ofertë ka

prezantuar edhe raportin e testimit nga laboratori ku shihet se trashësia është brenda parametrave të lejuar 1.2-1.5cm. Provë : Raporti i testimit nr.107NA/31.08.203 Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar. Për dallim nga eksperti shqyrtues, PSH këtë pretendim e klasifikon si pjesërisht të bazuar ngase AK në përgjigje në kërkesën për ri-shqyrtim ka ofruar edhe me foto matjen e mostrave të cilat e mbështesin vendimin e AK dhe për këtë përgjegjësi duhet të mbaj komisioni i vlerësimit të ofertave konform nenit 59.1 të LPP.
Lidhur me pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar për kontratë, Ankuesi pretendon se OE i rekomanduar ka ofruar një "fletushkë" në të cilën shënon standardi EN 20347. OE ankues pretendon se ky standard nuk është ajo çka është kërkuar , që është kërkuar realisht EN ISO 20347, si dhe OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar se produkti ofruar është në pajtim me kërkesën e dosjes për lidhëse rezistente ndaj ujit. Po ashtu, sipas OE kjo nuk plotëson kërkesën e dosjes për "raport të testimit. Paneli shqyrtues në këtë rast nuk e kupton ekspertin shqyrtues lidhur me konstatimin e tij se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmojë se produkti i ofruar është në përputhje me standardin EN ISO 20347, dhe se raporti testimit të OE të rekomanduar , nuk përmban as këtë të dhënë/testim, kur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar në ofertën e tij kopjen e çertifikatës për testimit të lëkurës dhe përmban standardin EN ISO 20347 dhe përmban rezistencën ndaj ujit. Po ashtu, vlenë të theksohet fakti se kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë "Për pjesën 1 Operatori Ekonomik duhet te sjell kopje te certifikatës apo Flete inspektim të lëshuar nga ndonjë laborator i certifikuar për inspektime testime te lëkurës". Andaj , pretendimi ankimor është i pa bazuar.
Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".
Paneli detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE i cili është rekomanduar për kontratë është për 241,200.00 €, më I lirë, e që ky fakt nuk ka mundur të mohohej as nga AK. Përveç kësaj AK duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.
Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".
Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i

pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Sabit Makiqi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: